



VIKTIMA TË
TREGTISË ME
QENIE NJERËZORE
NJOFTOHUNI ME TË
DREJTAT TUAJA
DHE MBËSHTET
JEN QË MUND
TË PRISNI

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe



ÇFARË PARAQET TREGTIA ME QENIE NJERËZORE?

Tregtia me qenie njerëzore është mjaft e njohur si një vepër penale serioze dhe shkelje e të drejtave të njeriut dhe si e tillë është përcaktuar në të drejtën vendore dhe ndërkombëtare. Tregtia me qenie njerëzore është forma e skllavërisë bashkëkohore. Një vepër penale bëhet kur tregtari me qenie njerëzore përdor, për shembull, dhunë, mashtrim ose detyrim për kontroll të ndonjë personi tjetër me qëllim, për shembull, të përfshirjes së tij/saj në aktivitete seksuale për përfitim ose për punësim, ose për dhënie të shërbimit. Tregtia me qenie njerëzore mund të përfshijë, por jo detyrimisht, transferim në ndonjë vendndodhje tjetër. Një person mund të konsiderohet si viktimë e tregtisë me qenie njerëzore pa marrë parasysh nëse janë të eksploator në qytetin e tyre të vendbanimit, nëse janë të transportuar për qëllim të eksploatimit, nëse paraprakisht kanë rënë dakord të punojnë për tregtar me qenie njerëzore, nëse kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale si pasojë e drejtpërdrejte e tregtimit me ata, ose nëse është bërë eksploatimi i tyre. Një fëmijë do të konsiderohet si viktimë e tregtisë me qenie njerëzore pa marrë parasysh se cilat mënyra (dhuna, mashtrimi, keqpërdorimi i pozitës së cenuar, etj.) janë përdorur për të rekrutuar fëmijën me qëllim të eksploatimit.

CILAT FORMA TË EKSPLOATIMIT EKZISTOJNË?

- o EKSPLOATIMI SEKSUAL
- o PUNË ME DHUNË
- o KËRKIMI LËMOSHËS ME DHUNË
- o MARTESA TË DHUNSHME
- o TREGTI PËR SHKAK TË NXJERRJES SË ORGANEVE
- o DETYRIM PËR KRYERJE TË VEPRAVE PENALE

SI MUND TË NJIHNI QË JENI VIKTIMË E TREGTISË ME QENIE NJERËZORE?

Nëse dikush ju detyron të punoni kundër vullnetit tuaj ose në kushte që nuk i keni zgjedhur dhe nëse nuk mund të largoheni, mund që të jeni viktimë

e tregtisë me qenie njerëzore. Ajo mund të ndodh gjatë kërkimit të punës ose kur udhëtoni prej një vendi në tjetër ose në një qytet tjetër për ndonjë qëllim tjetër – ndoshta ju kanë gënjyer për llojin e punës që do të bëni ose për kushtet në të cilat do të punoni dhe ju kanë marrë të hollat, pasaportën ose dokumentet personale dhe ju kanë detyruar të qëndroni në atë situatë me kërcënime për dhunë kundër jush, familjes suaj ose personave që i doni.

Ndonëse nuk është një listë përfundimtare, ka disa sinjale që mund të jenë paralajmërim:

- Ju kanë marrë pasaportën dhe dokumentet tjera për identifikim.
- Jeni të detyruar të përdorni identitet të rrejshëm (pasaportë dhe letërnjoftim të ndonjë personi tjetër).
- Jeni të detyruar të jepni shërbime seksuale klientëve.
- Trupi juaj përdoret për incizim të pornografisë.
- Nga trupi juaj është nxjerrë organ pa lejen tuaj.
- Jeni të ekspozuar në dhunë fizike, mendore ose seksuale (keqpërdorim, rrahje, përdhunim, të uritur, frikësim, etj.) sepse nuk jeni pajtuar të bëni atë që është kërkuar nga ju.
- Jeni të martuar kundër vullnetit tuaj dhe ndjeni që bashkëshorti ose familja e tij ju keqpërdor.
- Jeni të detyruar të punoni kundër vullnetit tuaj, në kushte të papranueshme, punoni për rrogë minimale ose aspak nuk merrni rrogë, jeni të ekspozuar në dhunë fizike ose mendore dhe lëvizja juaj është e kufizuar.
- Jeni të detyruar të bëni kontrabandë të drogës ose gjëra të tjera të paligjshme.
- Jeni të detyruar të kërkoni lëmoshë, me qëllim është shkaktuar e metë fizike ose duhet të shtirreni që jeni me të metë që të fitoni më tepër të holla.
- Vazhdimisht jeni të kërcënuar për jetë.
- Lëvizja juaj është e kufizuar dhe kontrolluar, vazhdimisht ju ndjekin se çfarë do të bëni ose do të thoni.
- Kur dilni, çdoherë keni shoqërim.
- Nuk keni qasje në mjete për komunikim (telefon, internet, etj.).
- Ju kërcënohen që familja juaj do të lëndohet.

ÇFARË DUHET TË BËNI QË TË MBROHENI?

Denonconi situatën tuaj në Qendrën për Punë Sociale ose në shoqata qytetare (telefonat për kontakt janë dhënë në fund të kësaj broshure) ose në stacionin më të afërt të policisë.

PERIUDHË PËR MARRJE TË VENDIMIT

Nëse pas bisedës së parë me policinë nuk ndjeheni të gatshëm të ndani informacionet për vuajtjet tuaja, mund të ju jepet periudhë për marrje të vendimit që të mund të shëroheni dhe të vendosni nëse do të bashkëpunoni me autoritetet kompetente, pa dallim a jeni shtetas i vendit ose shtetas i huaj.

Mekanizmi Kombëtar për Referim (MKR) do t'ju drejtojë në strehimore të sigurte dhe shërbime tjera të gatshme që do të ndihmojnë të shëroheni. Periudha për marrje të vendimit zgjat deri më dy muaj dhe nëse jeni fëmijë (në moshën nën 18 vjeç) kjo periudhë mund të vazhdohet.

Mbrojtja sigurohet me anë të zyrës së MKR-së në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, Ministrisë për Punë të Brendshme – Njësia për Luftë kundër Tregtisë me Qenie Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm si dhe OJQ “Otvorena Porta” dhe Za srekno detstvo” në Qendrën për Persona-Viktimë të Tregtisë me Qenie Njerëzore.

BËHUNI TË VETËDIJSHËM PËR TË DREJTAT TUAJ DHE MBËSHTETJEN QË E KENI NË DISPOZICION

- **TRANSPORT I SIGURT DHE STREHIM TË VIKTIMAVE TË TREGTISË ME QENIE NJERËZORE**—Pa marrë parasysh nëse jeni shtetas vendor ose i huaj, nëse nuk keni vend të sigurt për strehim, do të vendosni në Qendrën për Viktima të Tregtisë me Qenie Njerëzore, ku do të merrni ndihmën e një stafi profesional.
- **NDIHMË DHE MBËSHTETJE PSIKO-SOCIALE**—Do t'ju jepet mbështetje nga ekspertët e Qendrës për Punë Sociale. Do të sigurohen këshillime për shërbim, ndihmën për vendosje të kontaktit me familjen tuaj dhe sigurim për nxjerrjen e dokumenteve personale (certifikatë lindjeje, letërnjoftim, librezë shëndetësore, etj.).

- **NDIHMË SHËNDETËSORE**—Keni të drejtë për ndihmë themelore shëndetësore, por duhet të paguani kompensimin për bashkë-financim të detyruar. Nëse jeni shtetas i huaj, shërbimet themelore shëndetësore paguhen në tërësi. Në këto përfshihen kontrolle të përgjithshme, teste themelore të laboratorit dhe kontrolli i përgjithshëm gjinekologjik.
- **ARSIM**—Nëse keni ndërprerë arsimin, mund në mënyrë aktive të kyçeni në procesin arsimor, varësisht nga moshja juaj. Arsimi fillor dhe i mesëm në vend janë të detyrueshëm.
- **PUNËSIM**—Nëse jeni pa punë, dhe keni mbushur 15 vjet, mund të paraqiten në Agjencinë për Punësim në të cilën mund të merrni informacione për mundësitë e punësimit si viktimitë e tregtisë me qenie njerëzore. Nëse jeni shtetas i huaj, duhet të keni leje pune që të punoni, ndërsa qëndrimi juaj si i huaj në shtet duhet të rregullohet. OJQ-të mund t'ju ndihmojnë që të merrni informacione për mundësitë e punësimit.
- **KTHIM TË SIGURT**—Nëse jeni shtetas i huaj, keni të drejtë të kthimit të sigurt në atdheun tuaj. Nëse jeni fëmijë (në moshën nën 18 vjeç), gjatë udhëtimit tuaj duhet të shoqëroheni nga kujdestar i përkohshëm. Nëse jeni fëmijë, shtetas i Maqedonisë, vendimi për vendbanim të përhershëm do të merret nga ana e punëtorit social të Qendrës për Punë Sociale përkatëse, pasi që të merret mendimi juaj.
- **RE-INTEGRIM**—Keni të drejtë të kyçeni në krijimin e planit individual për re-integrimin tuaj që përfshin edhe mbështetje psiko-sociale, ndihmë juridike, arsim dhe shkathtësi jete, programe për përforsim ekonomik, këshillim familjar, etj.
- **NDIHMË JURIDIKE**—Do t'ju caktohet një avokat i cili do të sqarojë sistemin vendor ligjor, do të përfaqësojë të drejtat tuaja para gjykatës ose organeve tjera dhe do të ndihmojë të realizoni të drejtën tuaj për dëmshpërblim. Përveç kësaj, viktimat e tregtisë me qenie njerëzore që janë shtetas të huaj kanë të drejtë të lejeqëndrimit të përkohshëm, për azil, etj.
- **DËMSPËRBLIMI**—Keni të drejtë të dëmshpërblimit për vuajtjet gjatë eksploatimit në zinxhirin e tregtisë me qenie njerëzore, që përfshin dëmin material, dhimbjen emocionale, frikën, prekjen e nderit, reputacionit, lirisë, të drejtave personale, dinjitetin, etj.

KONTAKT ME INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT RELEVANTE PËR DHËNIEN E NDIHMËS DHE MBËSHTETJES PËR VIKTIMAT E TREGTISË ME QENIE NJERËZORE:

- **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale – Mekanizmi Kombëtar për Referim,**
telefon:023106443,
celular:076456795,celular:075311726
- **Policia:192**
- **Shoqata për Veprim kundër Dhunës dhe Tregtisë me Qenie Njerëzore – Otvorena Porta**
Linjë SOS falas
080011111;022700107
www.lastrada.org.mk;
e-posta:lastrada@lastrada.org.mk
- **Avokati i Popullit,**
rr. “Maqedonia” nr. 19
telefon:02 3129335;023 129359;
e-posta:contact@ombudsman.mk

PËR OTVORENA PORTA

Shoqata për Veprim kundër Dhunës dhe Tregtisë me Qenie Njerëzore – Otvorena Porta/La Strada është organizatë kombëtare joqeveritare që është tërësisht dedikuar luftës kundër tregtisë me qenie njerëzore. Nga themelimi në vitin 2000, Otvorena Porta në mënyrë të hapur trajton problemin e tregtisë me qenie njerëzore dhe në mënyrë aktive merr pjesë në krijimin e politikave dhe strategjive për të zvogëluar numrin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe sigurim të trajtimit më të mirë të viktimave. Otvorena Porta udhëheq me një strehimore në të cilën trajtohen viktimat e tregtisë me qenie njerëzore dhe ju jep shërbime viktimave për re-integrim të suksesshëm; ju jep informacione për problemin me tregtinë me qenie njerëzore dhe për mënyrat e parandalimit me anë të linjave SOS të telefonit që janë falas për ata që denoncojnë nga brenda shtetit.

Broshura nuk ka qëllim të këshillës juridike dhe nuk zëvendëson nevojën për kërkim të këshillës juridike.

Broshura është përpunuar me mjete të përbashkëta të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Në asnjë mënyra nuk mund të konsiderohet që shqyrtimet dhënë në këtë broshura pasqyrojnë mendimin e Këshillit të Evropës ose Bashkimit Evropian.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

